



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

VE N D I M

Nr. 126, datë 28.09.2020

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 64, DATË 12.06.2020, TË KËSHILLIT BASHKIAK
“PËR MIRATIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO - KULTUROR PRANË BASHKISË
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe “d”, nenit 25, pikat 2 dhe 4, nenit 54, shkronja “ç” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 540, datë 21.12.1992, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillave Artistiko – Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005, të ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor”, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020–2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1.Në vendimin nr. 64, datë 12.06.2020 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor pranë Bashkisë Tiranë”, bëhet ky ndryshim:

-Anëtari Z.Lorik Cana, zëvendësohet me Z.Alket Islami.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU